



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 753/25
Datë/Datum. 30.05.2025

PRISHTINË - PRIŠTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

OSHP nr. 75/25
Datë 29.05.2025

Sekretariati i Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik duke u bazuar në nenin 98 paragrafi 2 si dhe nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Komuna Gjakovë, me numër 75/25, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj (OE) "Andi E.E" - Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me shtreter, dyshek, çarçafë dhe tepiha për konvikt, çerdhe dhe klasa parafillore", me nr. të prokurimit: 632-24-4813-1-3-6, me datë 29.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET**, si e pa bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par. 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Komuna Gjakovë, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE Andi E.E, - Pejë, me nr. unik 811984550, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me shtretër, dyshek, çarçafë dhe tepiha për konvikt, çerdhe dhe klasa parafillore", me nr. të prokurimit: 632-24-4813-1-3-6. AK të drejtën ligjore mund të kërkoj ta realizoj sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD).

ARSYETIM

Kërkesa e AK- Komuna Gjakovë:

1. Autoriteti kontraktues përmes kërkesës së saj, ka kërkuar marrjen e masave sipas nenit 99.2 të LPP-se, ndaj OE "Andi E.E", - Pejë, me arsyetimin se me operatorin ekonomik kemi nënshkruar kontratë për aktivitetin e lartpërmendur dhe i njëjti në vazhdimësi nuk i është përgjigjur kërkesave për furnizim të AK-se, me produktet e kërkuara.

Pra, autoriteti kontraktues - Komuna Gjakovë, kërkon marrjen e masave sipas nenit 99.2 të LPP-se, me arsyetimin se OE Andi E.E, - Pejë, nuk e ka përmbushur kontratën.

Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me të pranuar kërkesën e datës: 22.01.2025, të AK - Komuna Gjakovë, e ka njoftuar OE Andi E.E, - Pejë, me qellim që operatori ekonomik në fjalë të jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

OE "Andi E.E", - Pejë, përmes përgjigjes së dhënë ka kërkuar nga OSHP, që kërkesa e AK të refuzohet si e pa bazuar duke e arsyetuar kryesisht se nuk kam mundur të siguroj llojin e produktit që e ka kërkuar AK-ja dhe nga ata kam kërkuar që ta sjell një lloj të ngjashëm por të njëjtn nuk kanë pranuar.

Shqyrtimi i kërkesës dhe vlerësimi i pretendimeve të Autoritetit Kontraktues për marrjen e masave ndaj OE Andi E.E, - Pejë:

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndë Kryesuesi i Sekretariatit, konstaton se autoriteti kontraktues – Komuna Gjakovë, nuk ka dorëzuar asnjë provë që dëshmon se OE Andi E.E, - Pejë, në këtë aktivitet të prokurimit, ka mashtruar apo ka falsifikuar ndonjë dokument apo dëshmi, për të cilën edhe OSHP, mund të merr masa konkrete ndaj operatorit ekonomik.

Bazuar në nenin 99.2 të LPP-së, Organi Shqyrtues i Prokurimit është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: *“Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare”*, e që në rastin konkret AK-ja, nuk ka arritur të ofroj ndonjë dëshmi apo prove për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e OE Andi E.E, - Pejë, për aktivitetin e prokurimit: *“furnizim me shtretër, dyshek, çarçafë dhe tepiha për konvikt, çerdhe dhe klasa parafillore”*, me nr. të prokurimit: 632-24-4813-1-3-6.

Prandaj OSHP konstaton në rastin konkret palët kontraktuale në kontratën e lidhur me datën: 19.06.2024, nuk kanë arritur ti zgjedhin në mënyrë miqësore mosmarrëveshjet që kanë pasur dhe se sipas kushteve të veçanta të kontratës palet mund ti referohen Gjykatës kompetente, kusht ky i vendosur nga vet palët kontraktuale, dhe se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me mashtrim apo falsifikim sipas dispozitave të nenit 99.2 të LPP-se.

Pa nevojë për sqarime tjera shtesë, OSHP vlerëson se Autoriteti Kontraktues të drejtën e tij kontraktuale mund të realizojë sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve pranë Gjykatës kompetente.

Duke u mbështetur në nenin 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna Gjakovë
- 1x1 OE Andi E.E, - Pejë
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

